REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
737, 765, 767/20
Nr/Br.
Datë/Datum. 23.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Gjemajli Bellanica eks. Shqyrtues *Lavdim Fejza eks.Teknik*	*Data e autorizimit të ekspertit* 13.10.2020	*Data e dorëzimit të raportit* 23.10.2020	Nr. i lëndës: 737-765-767/20

Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën:01.10.2020, 05.10.2020, 05.10.2020, OE-ve **"Ballkan Petrol"shpk- Ferizaj,"NTSH Ekoninvet"- Prishntinë dhe "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V&Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S"** ka parashtruar ankesë me nr: 737-765-767/20, kundër njoftimit për dhënie kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4"**,me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosoves"sh.a - KEK .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Pune, vlera e parashikuar e kontratës: 3.**850.000,00 Euro**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore- OE **"Ballkan Petrol"shpk- Ferizaj,"**

- **Neni 1 i LPP-së - Qëllimi**
- **Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
- **Neni 28 i LPP-së - Specifikimet Teknike**
- **Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
- **Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

- Me datë 11.09.2020 nga AK kemi pranuar njoftimin mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde mbi eliminimin lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4"**, me nr. Prokurimi: **KEK-20-620-5-1-1**, Nr I brendshem: **KEKC-20-041-511.**

Përmes letrës standarde mbi eliminimin ne jemi njoftuar nga ju si AK se jemi eliminuar nga ky aktivitet me arsyetimin:

JUSTIFICATION

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE-ve **"Ballkan Petrol"shpk- Ferizaj,"NTSH Ekoninvet"- Prishntinë dhe "Intrast shpk&Sulzer Turbo Venlo B.V&Turgan Enerji Sanay Ticaret A.S"** ka parashtruar ankesë me nr: 737-765-767/20, kundër njoftimit për dhënie kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Riparimi kapital i turbinës dhe gjeneratorit të bllokut A4"**,me nr. të prokurimit: KEK-20-620-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves - KEK

You are disqualified because you did not meet the criteria below:

- You have not completed the price description table of the optional part for positions: A4, A5, A6, A10, and A11, while the demand has been "The following tables (appendix no.1, appendix no.2 and appendix no.3) should be subject to mandatory prices, but the prices in these appendices will NOT be part of the Contract Price and will be used only on the basis of the need during the performance of the contract and with the consent of the Contracting Authority".

Ky veprim i Autoritetit Kontraktues respektivisht arsyetimi mbi eliminimin tonë është në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e parashtruara nga AK KEK në dosjen e tenderit si dhe me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, sepse vetë autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit e kanë cekur respektivisht sqaruar se pjesët opcionale nuk janë pjesë e kontratës bazë, këtë fakt e vërteton edhe vetë autoriteti kontraktues në arsyet e eliminimit. Poashtu edhe me rastin e hapjes së ofertave dhe hartimit të procesverbalit të hapjes çmimet lidhur me pjesët opcionale nuk janë lexuar fare.

- Provë: procesverbali i hapjes

Përkundër që veprimi i AK mbi eliminimin e ofertës tonë është në kundërshtim të plotë me kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit por edhe me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, ku thuhet se: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit",* me qëllim të trajtimit të barabartë me operatorët tjerë ekonomik, para se të merr vendim mbi eliminimin tonë AK është dashur paraprakisht që konform nenit 72 të LPP-së të kërkojë sqarime lidhur me mos plotësimin e pozicioneve tek çmimet opcionlae, te cilat AK i ka cekur në arsyjen e eliminimit.

Ju informojmë se ne i kemi plotësuar pozicionet A4, A5, A6, A10 dhe A11 me inicialet N/A për arsyet si vijon:

A.4	Flange bolts of HP casing (Per dimension)	complet	1	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionet A.4.1 deri A.4.14. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total.Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.4 ku AK ka vendosur **N/A**	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionet A.4.1 deri A.4.14. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total.Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.4 ku AK ka vendosur **N/A**

A.5	Diaphragm bolts (Per dimension)	complet	1	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionet A.5.1 deri A.5.2. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total. total. Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.5 ku AK ka vendosur **N/A**	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionet A.5.1 deri A.5.2. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total. total. Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.5 ku AK ka vendosur **N/A**
A.6	Bolts of diaphragm carrier (rings)bolts (Per dimension)	complet	1	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionin A.6.1. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total. total. Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.6 ku AK ka vendosur **N/A**	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se çmimi për këtë pozicion është zbërthyer në nënpozicionin A.6.1. Vendosja eventuale e çmimit do të shkaktonte dyfishim dhe rritjen fiktive të çmimit në total. total Rast i ngjajshëm është përdorur te pozicioni B.6 ku AK ka vendosur **N/A**
A.10	Diaphragms (Per dimension)	complet	1	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se nuk është definuar se për cilat dimenzione bëhet	**Koment**: Kjo fushë është plotësuar me **N/A**, për arsye se nuk është definuar se për cilat dimenzione
				fjalë siq është vepruar me pozicionin analog në pozicionin B.10 të kësaj tabele ku AK ka vendosur **N/A**	bëhet fjalë siq është vepruar me pozicionin analog në pozicionin B.10 të kësaj tabele ku AK ka vendosur **N/A**

A.11	Diaphragm rings (Per dimension)	complet	1	Koment: Kjo fushë është plotësuar me N/A, për arsye se nuk është definuar se për cilat dimenzione bëhet fjalë siq është vepruar me pozicionin analog në pozicionin B.11 të kësaj tabele ku AK ka vendosur N/A	Koment: Kjo fushë është plotësuar me N/A, për arsye se nuk është definuar se për cilat dimenzione bëhet fjalë siq është vepruar me pozicionin analog në pozicionin B.11 të kësaj tabele ku AK ka vendosur N/A

Përveq sqarimeve të lartëcekura, duke pas parasysh se Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit e kanë specifikuar se **Tabela e përshkrimit të çmimeve për Pjesët Opcionale nuk janë pjesë e kontratës bazë dhe se dakordimi paraprak mes Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontratktues**, nga kjo rrjedh se çmimet për Pjesët Opcionale nëse paraqitet nevoja për implementim të tyre paraprakisht do të negociohen mes OE-së dhe AK-së dhe me këtë rast nëse ne shpërblehemi me kontratë për të gjitha çmimet e pjesëve opcionale jemi të gatshëm t'i negociojmë paraprakisht me Autoritetin Kontraktues nëse paraqitet nevoja për implementim të ndonjë pjese opcionale dhe me këtë rast do ishin sqaruar të gjitha paqartësit rreth çmimeve për pjesët opcionale.

Po ashtu në njoftimin për kontratë dhe në FDT tek neni 7.1 "Qëllimi i Kontrates", projekti në fjalë është kërkuar të jetë si***" projekt me çelës në dorë",*** kështu që ne rast se shpërblehemi me kontratë dhe nëse eventualisht vie deri te realizimi i pikave te kontrates, paraprakisht pëmes negociatave do të duhet të arrihej marrëveshja e kënaqshme për të dyja palët. Po ashtu eliminimi i ofertës tonë nga ky aktivitet i prokurimit me arsytimin se nuk i kemi plotësuar disa çmime për pjeset opcionale është në kundërshtim të plotë me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së sepse për kundër që ne si Operator Ekonomik i kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret obligative te parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit për kontratën bazë dhe jemi operatori ekonomik i përgjegjshëm me ofertën finaciare më të lirë, AK na ka eliminuar me arsytim banal për kinse çmime të pjesëve opcionale të cilat nuk janë pjesë e kontratës bazë, çmimet nuk janë lexuar në procesverbalin e hapjes, nuk janë pjesë e vlerësimit, njëashtu askund nuk ceket buxheti i paraparë për çmime opcionale dhe ndoshta fare nuk do të paraqitet nevoja të implementohen këto pjesë opcionale me rastin e implementimit të kontratës bazë, e ndërsa në anën tjetër duke mos marr parasysh qëllimin e ligjit të prokurimit, duke mos qenë efikas dhe duke mos na trajtuar barabartë me operatorët tjerë ekonomik, sepse AK ka favorizuar dhe rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Dietsmann Technology S.A" e cila është e pa përgjegjshme për çështje tjera të argumentuara më poshtë:

Nëse krahasohen çmimet e tregut me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë për pjesët opcionale, shifet çartë se çmimet e ofruara janë inekzistente, fiktive dhe JO NORMALISHT të ulëta.

Si shembull: Nëse analizohet çmimi i pjesës opcionale të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për pozicionet:

Pika A.1 është ofruar çmimi total 16,522.79€.
Pika B.1 është ofruar çmimi 6,458.91€
Pika B.12 është ofruar çmimi 3,304.56€
Totali për këto tri pozicione është: 26,286.26€
Pozicionet e theksuara më lartë kapin vlerën e tregut real me miliona Euro e jo me një total qesharak prej 26,286.26€.

Lehtësisht konstatohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime të cilat janë rreth **100 herë** më të lira se sa çmimet reale të tregut për të njëjtat pozicione, po thuajse njëjtë ka vepruar edhe tek pozicionet tjera për çmimet e pjesëve opcionale.

Andaj nëse AK është dashur ta eliminoj ndonjë OE, për çmime të pjesëve opcionale konform nenit 61 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, është dashur pikërisht ta eliminoj OE e rekomanduar për kontratë, për shkak se e njëjta ka ofruar çmime fiktive, jo reale dhe jo normalisht të ulëta me çmimet e tregut, e jo ta favorizoj te njëjtin duke e rekomanduar për kontratë dhe mos u marr fare më çmimet e pjesëve opcionale të cilat i ka ofertuar ndërsa neve duke na trajtuar në mënyrë jo të barabartë na eliminon për kinse mos ofrim të çmimeve për pjesë opcionale tek disa pozicione, të cilat nuk janë fare pjesë e kontratës bazë dhe të cilat janë të sqaruara në tabelat e mësipërme.

Në vendimin e dates 24.09.2020 me të cilin është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 16.09.2020, në paragrafin e fundit AK ka theksuar: "Sa i përket pretendimeve se çmimet janë të ulëta nga O.E Dietsmann Technologies S.A. vlerësimi I komisionit është se çmimet janë te pranushme dhe operatori është zotuar se do t'i realizoj furnizimet dhe montimet me çmimet e ofruara për pozicionet e cekura". Ne dyshojmë se ky deklarim i AK-së nuk është i vërtetë sepse me rastin e kërkesës dhe çasjes tonë në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë por edhe në dokumentacionin e procedures së vlerësimit në AK, nuk kemi hasur në asnjë dokument të shkruar me të cilin është zotuar OE i rekomanduar për kontratë se do ti realizoj furnizimet dhe montimet me çmimet e ofruara për pozicionet e cekura tek pjeset opcionale.

Po ashtu më letren standarte te dates 19.08.2020 AK ka kërkuar sqarime për 7 pika nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo asnjëra nga këto sqarime/pika nuk ka të bëjë me çmimet opcionale të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, andaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së, që të

verifikojë dhe kërkojë nga AK që të dëshmoj atë që kanë theksuar në vendimin e dates 24.09.2020 se OE i rekomanduar për kontratë është zotuar me shkrim se furnizimet dhe montimet e pjesve opcionale do ti realizoj me çmimet e ofertura me rastin e dorëzimit të ofertes. Po ashtu edhe nëse do të kishte një deklarim të tillë nga OE i rekomanduar për kontratë do të ishte jo real dhe i rrejshem sepse është e pamundur që pjeset opcionale të përshkruara në dosjen e tenderit nga AK që kushtojn ***me miliona euro në treg****, të realizohen me çmimet e ofertuara nga OE i rekomanduar për kontratë:*

Pika A.1 është ofruar me çmimi total 16,522.79€.

Pika B.1 është ofruar çmimi 6,458.91€

Pika B. 12 është ofruar çmimi 3,304.56€

Totali për këto tri pozicione është: ***26,286.26€.***

Ne jemi të vetëdijshëm se çmimet opcionale nuk janë pjesë e vlerësimit, por nuk e kemi të çartë se pse AK është marrë vetëm me pjesën opcionale të ofruar nga ne si OE, kurse Opertatorët tjerë i ka anashkaluar e në veqanti OE e rekomanduar për kontratë.

Athua vallë ofertës sonë AK nuk ka mundur ti gjej vërejtje tjera dhe është fokusuar në diçka jorelevante e cila nuk është pjesë bazë e kontratës.

- Si argument shtesë ju bashkangjesim edhe një interpretim nga KRPP-ja për rastin konkret dhe opinioni i tyre është si më poshtë:

From: Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, September 16, 2020 8:43 AM
To: Ballkan Petrol <info@ballkanpetrol.com>
Subject: Re: Plotesim i kerkeses urgjente per interpretim

Te nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Sipas nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të LPP-së, në funksion të KRPP-së është " **t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP".**

Sipas nenit 59 të LPP-**<u>së, vlerësimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.</u>**

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së,***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".***

Sa i perkete pyetjes tuaj,citat:**„ Autoriteti Kontraktues a ka të drejtë që me rastin e vlerësimit të ofertave të marr për bazë tabelën e çmimeve për pjeset opcionale edhe pse të njejtat çmime nuk janë lexuar në hapje, nuk është pjesë e kontratës dhe nuk është kriter vlerësues duke mënkuptuar se nëse vlerësimi implementimi eventual të ndonjë pjese opcionale, çmimet për secilën pjesë paraprakisht do të negociohen në mes AK dhe OE i cili do ta implementojë kontraten?"**,**OPINIONI** i KRPP-së është si ne vijim:

Nëse „ Lista e çmimeve opcionale''nuke është lexuar në hapje, nuk është pjesë e kontratës dhe nuk është kriter vlerësues,e njejta nuk duhet të jetë kusht per eliminim.Tenderet duhet te vleresohen ne baze te kritereve te perzgjedhjes dhe kritetreve te dhenjes te percaktuara ne dosjen e tenderit dhe te njoftimit per kontrate ne perputhje me paragrafin e lartecituar.

Për të gjithë Operatorët Ekonomik që pretendojnë se kërkesat, kriteret, kushtet specifikimet apo dëshmitë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nuk janë vendosur në pajtim me legjislacionin e prokurimit, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,
Departamenti i Rregullave-KRPP.

Në vazhdim do ti elaborojmë mungesat tjera që kemi hasur në ofertën e OE "Dietsmann Technology S.A", të rekomanduar për kontratë, nga AK:

1. *Operatori Ekonomik "Dietsmann Technology S.A", nuk është i përgjegjshëm sepse me rastin e dorëzimit të ofertës në kundërshtim më kërkesat e parashtruara në ANEKSIN 1 të dosjes së tenderit ku është kërkuar decidivisht që Operatorët Ekonomik e kanë për obligim që të dorëzojnë:*

"a. Deklarate per afatin e garancionit 12000 orë pune, nga dita e lëshimit të qertifikates nga TC-A për operim të rregullt me bllokun A4."

OE i rekomanduar për kontratë **nuk ka dorëzuar fare një deklaratë për afatin e garancionit** siç e ka kërkuar AK në Dosjen e Tenderit, por ka dorëzuar një dokument respektivisht Propozim Teknik, në të cilin përveq disa elementeve tjera, në piken 1.11, ka theksuar:

1.11 Technical qualifications

1.11.1 VVarranty and performances

The vvarranty period of the Products shall expire twelve-thousands (12,000) running hours afterthe date of installation of the Products in the equipment, or twenty-four (24) months after the delivery of the parts to the site whichever expires first.

The warranty and performance conditions are valid if and only if:

- the spare parts already available at site, within Company warehouse, are conform to genuine parts

Company purchases all spares indicated by EO as deemed necessary for replacement.

Ky deklarim/theksim i OE të rekomanduar për kontratë në propozimin teknik, ku ka theksuar se garancioni do të

*skadojë 12,000 orë pas datës së instalimit të produktit **apo 24 muaj pas liferimit, cili do që skadon i pari,** është në kundërshtim të plotë me kërkesën-kushtin administrativ të parashtruar nga AK në dosjen e tenderit sepse nga kjo rrjedh se OE i rekomanduar për kontratë mund ta liferoj paisjen dhe të skadoj afati prej 24 muaj pa ndodhur ende instalimi dhe testimi i paisjes në bllokun A4 si dhe pa u lëshuar certifikata nga TC-A.*

Shembull: *afati prej 24 muaj mund të skadon me 6000 apo 8000 orë pune pa e përbushur kushtin thelbësor që është kërkuar 12,000 orë pune. Jo rastësist AK ka kërkuar garancionin decidivisht 12,000 orë pune.*

Me këtë deklarim në propozimin teknik OE i rekomanduar për kontratë e ka futur në lajthitje AK, apo nëse AK e ka pranuar deklarimin/theksimin e OE në formen e tillë atëher me këtë veprim do të vepronte në kundërshtim me kushtin administrative të parashtruar në dosjen e tenderit si dhe në kundershtim me nenin 7 të LPP-së sepse me veprimin e tillë e kanë favorizuar Operatorin Ekonomik "Dietsmann Technology S.A" të rekomanduar për kontratë.

*AK në kundërshtim me rregullat për prokurim publik dhe duke dashur ta favorizoj OE e rekomanduar përmes letres standarde ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik lidhur me pikën e lartëcekur respektivisht deklaratën e OE të dhënë në propozimin teknik, mirëpo më rastin e sqarimit OE me daten 28.08.2020 përsëri nuk ka ofruar ndonjë deklaratë të veqantë rreth garancionit sipas kërkesës së parashtruar nga AK në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, por vetem ka theksuar se **"garancioni per turbine/generator do të jetë 12,000 orë pune". K**y deklarim dhe sqarim i ofertës nga ana e operatorit ekonomik është ndryshim-ndërrim substancial i ofertës nga ana e operatorit ekonomik dhe në kundërshtim të plotë me nenin 72 të LPP-së dhe 39 të RRUOPP me të cilën u mundësohet AK dhe operatorëve ekonomik të sqarojnë dhe plotësojnë dokumentacionin që mund të vërtetohen se kanë ekzistuar para datës së dorëzimit të ofertës e jo si në rastin konkret që të ndryshohet deklarata respektivisht oferta, kërkesë e cila ka qenë obligative në dosjen e tenderit.*

1. *Po ashtu OE "Dietsmann Technology S.A" i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. respektivisht lidhur me kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT për pikën:*

"2. Lista e personelit qe do te angazhohet ne realizimin e projektit: a) Menaxheri i projektit, duhet te kete pervoje ne udheheqjen e se paku tri riparimeve kapitale te turbines dhe gjeneratorit elektrik. Te dëshmohet me CV, kopje te diplomes dhe kontratë pune."

*OE i rekomanduar për kontratë lidhur më kërkësën/dëshminë e lartë cekur nuk ka dorëzuar fare **listë me emra të personelit qe do ti angazhon në këtë projekt**- përveq që në dokument propozimin teknik ka specifikuar llojet e profesioneve të stafit që nevoiten për implementimin e projektit, por pa e specifikuar asnjë emer të personave/stafit që i ka në dispozicion, respektivisht që do ti angazhon në implemetimin e projektit dhe që janë të profesioneve siç i ka specifikuar profesionet edhe vet OE në propozimin teknik.*

*Po ashtu, OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me projektmenaxherin **z.Karim Mikati** të caktuar për menaxhim të kontratës, nuk ka ofruar dëshmi se i njejti ka pervojë në udhëheqjen e së paku tri riparimeve kapitale të turbinës dhe gjeneratorit elektrik siç është kërkuar nga AK.*

AK përmes letrës standarde ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë lidhur me përvojen e menaxherit të kontratës duke parashtruar pyetjen:

2. Based on Project Manager CV. please provide us the evidence that proves that the Project Manager has implemented (led) at least three similar projects in Major Overhaul of Turbines and Generators during last 25 years of experience.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë me rastin e sqarimit në pyetjen e lartë cekur ka dorëzuar vetëm një deklaratë personale me logo të OE "Dietsmann Technologies S.A" të lëshuar dhe nënshkruar nga vetë z.Karim Mikati, dhe nuk specifikon se ku, kur dhe cilat projekte i ka mbikqyrë.

Provë: Deklarata e z.Karim M

Dietsmann
Maintaining Energy

Karim Mikati
Tripoli/Lebanon

Ref: KEK Kosovo - Major Overhaul of turbine and generator unit A4 / PM references

Date: 19th August 2020

Statement

I, Karim Mikati, hereby declare following previous experience:

During my assignment with Dietsmann in Russia for client REP/ENEL as Deputy Technical & Production Director, I supervised more than 3 major LMZ Steam Turbine and Generator overhauls at SUGRES power plant.

Karim Mikati

Signature

- Po ashtu AK pëmes Letrës Standarde ka kërkuar nga project menaxheri të prezentoj kopjen e kontratës mes tij dhe kompanisë "Dietsmann Technologies" S.A,

3. In regard to Project Manager, the following documents are required: the copy of the diploma as well as the employment contract with the company "Dietsmann Technologies".

ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur një kontratë të punës me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me address në Nicosia, Qipro, dhe kjo kontratë e punës e projektmenaxherit

z.Karim Mikati, nuk ka lidhje me Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë "Dietsmann Technology *S.A" me adresë Zone Industrielle 31260 Salies du Salat France", me të cilën vërtetohet se z.Karim Mikati nuk është punëtor i OE të rekomanduar për kontratë.*

Në vendimin e dates 24.09.2020 me të cilin është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 16.09.2020, AK vetë e ka vërtetuar se z.Karim Mikati ka kontratë pune me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me address në Nicosia, Qipro, duke e arsytuar se njejta kompani është degë e "Dietsmann Technology S.A", mirëpo në AK operatori ekonomik "Dietsmann Technology S.A" ka dorëzuar oferten si i vetëm dhe nuk ka bashkangjitur asnjë marrëveshje konzorciumi apo marrëveshje tjeter me kompaninë "D.M.N. STAFFING SERVICES LTD" me address në Nicosia, Qipro, sepse edhe nëse e njëjta kompani është degë e operatori ekonomik "Dietsmann Technology S.A", e njeta në bazë të legjislacionit konsiderohet biznes në vete dhe për të ofertuar me stafin e kësaj kompanie paraprakisht është dashur të lidhej ndonjë marrëveshje mes dy kompanive dhe të dorëzohej së bashku me dokumentacionin tjeter me rastin e ofertimit të operatorit ekonomik "Dietsmann Technology S.A".

Nga faktet e paraqitura më lartë vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me menaxherin e propozuar për projekt z.Karim Mikati nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftushme dhe të sakta siç është kërkuar, me kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit dhe letrës standarde për sqarime.

2. *AK përmes letrës standarde gjithashtu ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për intervenim në rast të defekteve të paraqitura ku ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë të dëshmoj qartë se do të intervenoj brenda 72 orëve pas dates së njoftimit nga AK*
Përgjigja e OE "Dietsmann Technology S.A" nuk është konform me kërkesën e AK gjithashtu kjo deklaratë është dashur të ofrohet me ofertë e jo me sqarime plotësuese.

3. *Poashtu është kërkuar një deklaratë për garancion prej 12,000 orë pune për pjesët që ndërrohen gjatë periudhës së garancionit.*
Përgjigja e OE "Dietsmann Technology S.A" nuk është konform me kërkesën e AK gjithashtu kjo deklaratë është dashur të ofrohet me ofertë e jo me sqarime plotësuese.

- Autoriteti Kontraktues bazuar në faktet e lartëcekura OE "Dietsmann Technologies S.A" duhet ta shpallë të papërgjegjshëm dhe ta eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo ta rekomandoj për kontratë.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore-"NTSH Ekoninvet"- Prishntinë

Neni 7

Neni 59

Neni 60

Neni 69

MUNGOJNË REFERENCAT:

Sa i përket referencave të paraqitura nga OE i rekomanduar për kontratë, ne pas analizës të të gjitha dokumenteve të dërguara për "referenca" kemi vërejtur që ansjëra nga këto dokumente nuk përmbush kushtet e paraqitura nga vet AK, ku kërkohen 2 referenca që dëshmojnë se është kryer punë në remontit kapital të turbines dhe gjeneratorit. Për më tepër detajet për këto referenca, ne kemi analizuar secilën vec e vec dhe janë të paraqitura më poshtë.

- *Referenca e pare* *të përkthyer me sqarime shtesë (SHIH REF1) - sqarojmë se ky document është -certificate teknike që përshkruan punët në turbinën T300-240 në njësinë 10. Kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime* ***kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.***
Referenea në fjalë, nuk është reference për përfundimin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetëm disa punëve në turbine.

- ***Referenca e dyte*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shtese (SHIII REF2) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tilie nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jctë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit.*

- ***Referenca e trete*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shtese (SHIH REF3.) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qc,'ë. që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet < fundit.*

- ***Referenca c katert*** *e paraqitur ne permbajtjcn e refereneave me sqarime shtese (SHII I REF4) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit.*

- ***Referenca e peste*** *e paraqitur ne permbajtjen e ceiërencave me sqarime shtese (SHIH REF5) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepsc kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit.*

- ***Referenca e gjashte*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shtese (SFIIII REF6) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit.*

- ***Referenca e shtate*** *e paraqitur ne permbajtjen e refcrencave me sqarime shtese (SHIH REF7) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit.*

- ***Referenca e letë*** *e paraqitur në përmbajtjen e referncavc me sqarime shtesë (SHIII REF8) është certificate e pranimit të punëve të zëvendësimit të bërthamave të valvave të presionit të lartë gjatë remontit. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*
Referenca në fjalë, nuk është reference për përfundiniin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjcneratorit, vetem disa valvave.

- ***Referenca e nente*** *e paraqitur në përmbajtjen e referncave me sqarime shtesë (SFIII I REF9) eshte raport I pranimit dhe raport Teknik I cili tregon qarte se punet qe jane kryer vetem ne gjenerator dhe jo ne turbine.*

Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.

Referenca në fjalë, nuk është reference për përfundimin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetem gjeneratorit.

- ***Referenca e dhjetë*** *e paraqitur në përmbajtjen e referncave me sqarime shtesë (SHII I REFIO) është certificate që përshkruan disa punë qëjanë kryer në systemin e kontrollit dhe distribuimit të avullit në turbine. Pra kjo reference përshkruan disa punë (kryesisht valva dhe sisteme të kontrollit) që janë riparuar. Kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*
- *Refercnca në fjalë, nuk është refcrence për përfundimin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetem gjeneratorit*

  - ***Referenca e njembedhjete*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shlese (SHIH REFl 1) - eshte e leshuar ne vitin 2015 dhe si e tille nuk pranohet sepse kerkesa ne FDT ka qenë që referenca të jetë për punët e përfunduara në tri vitet e fundit*

  - ***Referenca e dymbedhjete*** *e paraqilur ne permbajtjen s.referencave me sqarime shtese I (SHTFI REF12) është certificale për kontrollin e opermit. ne ndërprcrësat centrifugal për i sistemet e kontrollit në gjenerator. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhc 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*

  Referenca në fjalë, nuk është reference për përfundmiin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetemgjenerator.
- ***Refcrenca e trembedhjete*** *e paraqitur ne permbajtjen e refereneave me sqarime shtese (SHIIT REF13) eshte certifieate per kompletimin e disa puneve ne rotorin e presionit te larte, te mesem dhe te ulet te turbines. Punet e pershkruara jane pastrim I rotorit dhe balancim I rotorit, por nuk jane pune te remontit kapital. Kjo certificate eshte leshuar vetem per pune ne turbine. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohct reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*
- *Referenca në fjalë, nuk është reference për përfundimin e punëve në riparinie kapitale të turbines dhc gjeneratorit, por vetem gjeneratorit*

  - ***Referenca e katermbedhjete*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarimc shtese (SFIIH REF14) është cerfitikate e kompletimit të punëve në pjesët e qarkullimit të avullit në turbine. Pra në këtë reference përshkruhen qartë punët që janë kryer vetëm në turbine dhe jo në gjenerator. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*
- *Referenca në fjalë, nuk është reference për përfundimin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetein gjeneratorit*

  - ***Referenca e pesembedhjete*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shtese (SHIFI REF15) është raport per mbylljen e cilindrit te shtypjes se ulet. Pra në këtë reference përshkruhen qartë punët që janë kryer vetëm në turbine dhe jo në gjenerator. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përpulhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit ku kërkohet reference për përfundim të punëve nëriparimc kapitale të turbines dhe gjeneneratorit.*

  Referenca në fjalë, nuk është refercnce për përfundiniin c punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetemgjeneratorit

- ***Referenca e gjashtembedhjete*** *e paraqitur ne permbajtjen e referencave me sqarime shtese (SHIFI REF16) është certificate e kompletimit te puneve ne systemin e kontrollit dhe systemin e lengut zjarrdurues. Pra kjo reference nuk duhet të pranohet për shkak se nuk është në përputhshmëri me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderil ku kërkohet reference për përfundim të punëve në riparime*

kapitale të turbines dhc gjeneneratorit.Referenea në fjalë, nuk është reference për përfundimin e punëve në riparime kapitale të turbines dhe gjeneratorit, por vetem gjeneratorit.

MUNGON MENAXHERII PROJEKTIT ADEKUAT:

OE I rekomanduar për kontratë ka deklaruar se personi KARIM MIKATI do të jetë projekt menaxher për këtë projeki. Kërkesa në dosjen e tenderit sa I përket menaxherit të projeklit ka qenë si në vijim:

"Menaxheri I projektit që do të angazhohet në realizimin e projektit duhet të ketë përvojë në udhëheqjen e së paku tri riparimeve kapitale të turbines dhe gjeneratorit elektrik."

Menaxherit të projektit I deklaruar për këtë kontrate 1 mungon eksperienca e menaxhimit të projektil në tri riparime kapitale të turbim dhe gjeneratorit. Ne kemi analizuar secilën punë që ky person ka kryer dhe asnjëra nuk e përmbush kushtin e paracaktuar nga vet AK.

2017-Presenl

Ky person ka deklaruar se nga viti 2017 e tulje është I angazhuar si ekspert I pavarur (freelance) dhe nuk është më punëtor I DIETSMAN. Këtë e ka vërtetuar edhe me sqarim shtesë ku në dokumentin Lettër.of appointment dhe Contract of employment që I njejti ka qenë I angazhuar në fund vetërn për një projekt specifik (SHIH Kontrata)

2017

Ky person ka qenë I angazhuar si zëvendës drejtor I termoelektranës. Nuk ceket se ka menaxhuar remonte kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2016

1 angazhuar si trajner. Nuk ceket se ka menaxhuar remonte kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2015-2016

I angazhuar si këshilltar I operacioneve. Nuk ceket se ka menaxhuar remonte kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2015

1 angazhuar si projekl menaxher - VETËM për pregaditjen e dokumenteve teknike dhe komerciale. Nuk ka menaxhuar remonte kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2014-2015

Zëvendës drejlor Teknik - Ka cekur se ka përkrahur teknikisht ekipin e mirëmbajtjes dhe nuk ka cekur se ka menaxhuar projektin e riparimeve kapitale sic kërkohet në dosjcn e tenderit.

2013-2014

Supervizor 1 impiantit - Nuk ceket se ka menaxhuar projekte të riparimeve kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2011-2013

Drejtor I projekteve në MEW. Ka reprezentuar EDL në ministrinë e Energjisë, ujërave dhe ka bërë vlerësimin e ofërtave për tenderë. Nuk ceket se ka menaxhuar projekte të riparimeve kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2010-2011

Menaxher I operimeve - ka bërë trainime të personelit dhe mbikqyrje të turbinave me gas. Nuk ceket se ka menaxhuar projekte të riparimeve kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

2006-2010

Drejtor I termocentralit - Ka administruar me tcrmoelektranën. Nuk ceket se ka menaxhuar projckte të riparimevc kapitalc sic kërkohet në dosjen e tenderit.

1999-2006

Zëvendës drejtor 1 termoccntralit & IJdhëheqës I departamentit të mekanikës – Ka menaxhuar procedura të prokurimit dhe trainime. Nuk ceket se ka menaxhuar projekte të riparimcve kapitale sic kërkohet në dosjen e tenderit.

Për të njejtin është kërkuar sqarim dhe qarimi i ofruar nga OE I rekomanduar për kontratë nuk e bën të pranueshëm Si projekt menaxher personin e propozuar. Të njejtit i mungon eksperienca direkte në udhëheqjen e remonteve kapitale ashtu sic kërkohet në dosjen e tenderit.

MUNGOJNE DESHMITE PER PAISJET:

Në dosjen e tenderit, në Aneks 1 kërkohet (SHIH ANEKSI):

Pika 14: Pajisje mobile për përpunime e CPL, CPM dhe CPU, shtëpizave dhe foleve të valvave stopuese, mbrojtëse, rregulluese në TPL dhe TPM. **Prezantimi i pamjevc teknike të këtyre makinave përpunuese. OE është i obliguar të ofrojë dëshmi që posedon pajisje** për sanimin e defekteve -demtimeve në lopatat e diafragmave të turbinës me metodën e saldimit. Saldimi të bëhet në vend

Pika 17: Pajisja mobile për matjen e vibrimeve për analizë dhe balancim. **OE është I obliguar të ofrojë dëshmi që posedon pajisje për matjen e vibrimeve dhe balancimin e rotorëve të turbines**

OE I rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara në pikat e mësipërme se posedon paisje për kryerjen e punëve.

Për më tepër, në dokumentin e OE "KEK-2-620-5-I-I_Qualification Evidence & Technical Proposal_rev00.pdf' kemi identifikuar nën pikën 1.13 të mëposhtmet (SHIH DIETSMAN DEKLARATA):

Pika 1. OE nuk deklaron se posedon paisje për balancim të rotorit deri në 3000 rrotullime ashtu sic kërkohet në dosjen e tenderit. Për më tepër aty ceket se "OE do të ketë disponueshmëri, përmes nënkontraktorëve të përshtatshëm, paisje për balancim deri në 3000 rrotullime". Ky OE ka pranuar se nuk I posedon këto paisje, nuk ofron dëshmi për këto paisje dhe për më tepër deklaron se përmes një pale të tretë mund të ketë qasje në këto paisje.

Në dosjen e tenderit, aneks 1 kërkohet "deklaratë për posedimin e kuat*drit të specializuar për këto punë: Diagnostifikim, saldues te certifikuar, riparim, shtëllim të sistemit mekanik-hidralik të vajit të turbinëspër ngarkesë 200 MV. " OE I rekomanduar për kontratë deklaron se do të ketë disponueshmëri, perms nënkontraktorëve të përshtatshëm, kuadro të specializuara për punët:*
diagnostfikim, saldues të certifikuar, riparim, shtellim të sistemit mekanik- hidraulik të vajit të turbines për ngarkesë 200MW". Pra, ky OE nuk posedon stafin dhe makineritë mirëpo do të tentojë të sigurojë të njejtat përmes nënkontraktorëve.

Në dosjen e tenderit, në specifikimin Teknik, pikat 14 dhe 17 të cituara më sipër, kërkohet të dëshmohet përmes prezantimeve teknike se ky OE ka ato paisje. OE I rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur prezantime teknike për paisjet e kërkuara në pikat 14 dhe i 7. Për më tepër ai ka deklaruar se vet nuk I ka ato paisje, mirëpo sic cekel në dokumcntin e siperpërmendur deklaron se "OE do të ketë disponueshmëri, përmes nënkontraktorëve të përshtatshëm, paisjet dhe mjetet për të kryer remontin". Pra **ky** OE NUK POSEDON paisjet dhe qëllimi i tyre ka qenë që këto paisje t'I sigurojë në një afat të mëvonshëm nga nënkontraktorët.

Me të gjitha të të dftënat rne sipër/kemi konstatuar se OE 1 rekomanduar pëv koniratë nuk ka përmbushur k'riiërei ë nevojshme për të qenë I rekomanduar për kontfatë.'Ky OE ka dështuar të faktojë se përmbush kriteret c paracaktuara nga AK për: referenca, menaxher të projektit dhe dëshmitë për posedim të paisjeve dhe mjeteve për të kryer punël e remontit.
Me mangësitc **ë** dëshmuara më sipër, një komision vlerësues që ka për qëlhm dhënien e kontratës meritore, do të eliminonte nga konkurenca e mëtutjeshme OE Dietsman për mospërmbushje të kritereve të caktuara nga vet AK.

FAKTET QË DËSHMOJNË SE NE JEMI ELIMINUAR PADREJTËSISHT

Ne kemi pranuar letrën për tenderuesin e eliminuar dhe nuk pajlohemi me arsyelimet e paraqitura në këtë formë.

Certifikata e pranimit nr. 400 është më tepër se referencë e cila është e lëshuar nga vet ju.

Për më tcpër, në këtë certifikatë ceket se: "OEI ka përmhushur kriteret për përfundimin e suksesshëm të këtij projekti". Kjo është e nënshkruar nga project menaxheri njëherit drejtori i Kosovës A- Verdi Murtezi, për ku

kërkohet të punohet në këtë projekt. Arsyetimi juaj për eliminim është shumë tendencioz, I pakuptimtë dhe me qëllim që në cdo formë të na bëjë të papërgjegjshëm.

Arsyetimi banal se "blloku A3 është ende nën garancion me probleme të kohëpaskohshme" është 1 cudilshëm dhe poashtu vendosë dyshime në paanshmërinë e komisionit vlerësues. Në asnjë rast nuk është kërkuar që puna e referencuar të jetë "jashtë garancionit" sepse ajo kërkesë nuk ka kurrëfarë logjike dhe është deklaratë aspak profesionale për një komision vlerësues për një project *të këtij kompleksiteti. Duke thënë se projekti ka probleme të kohëpaskohëshme, ky komision në mënyrë të drejtëpërdrejtë ka shkelur cdo rregull të etikës profesionale duke gënjyer dhe shpifur. Ne kemi ofruar certifikatën e pranimit ku ceket se projekti është përfunduar me sukses (SIIIII CERTIFIKATA) dhe për më lepër, ne mund të dëshmojmë se nuk ka pasë asnjë ndalesë në pagesa për këtë projekt dhe nu ka asnjë vërejtje nga komisioni përfundimtar pranues që do të dëshmonte se punët nuk janë kryer sic duhet.*

Andaj arsyetimi I pare I komisionit vlerësues sa është banal është edhe tendencioz dhe për këtë ne do të kërkojmë nga instancat e kontrollit të brendshëm dhe instancat relevante për sjelljet e nëpunësve të AK që lë hetojë rastin për shpifje dhe mashtrim.

Sa I përket arsyetimit të dytë ju gabimisht keni konkluduar se punët në gjenerator janë kryer nga SE Plant Electrosystems. Ne këtë e kemi dëshmuar me sqarimin që keni kërkuar me uale 19.08.2020, ku keni kërkuar kontratën mes ZRE dhe SE Plant Electrosystems (SEIIH Kontrata ZRE- SE) ku decidivisht ceket se SE Plant Electrosystems ka bërë liferimin e pjcsëve për gjenerator dhe mbikqyrjen e punëve që ZRE ka kryër në gjenerator.

Edhe në këte arsyetim vërehet qartë tendenca e komisionit vlerësues të AK-se që të shtrembojë faktet vetëm me qëllimin kryesor të dëmtonet imazhi I kompanisë tone dhe të I jepet trajtim preferencial ndonjë kompanie që tentohet. Me çdo kusht ti jepet kontrata.

Duke llogaritur se dy arsyetimet e para faktojnë që referenca? e paraqiiura nga ne janë të mjaflueshme dhe përmbushin 100% krieteret e përcaktuara nga AK, arsyetimi I tretë duhet të fshihet në tërësi sepse nuk vlen.

